



Datë: 18.03.2026  
Numër Protokolli: 1442/2026

A.nr.107/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.107/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi S.R, kundër Vendimit me Nr.2397/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Pezullohet** procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.107/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi S.R.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil S.R (*tutje referuar ankuesi*), më datë 26.01.2026 (përmes postës), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 30.01.2026 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.107/2026, kundër Vendimit me Nr.2397/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, ky i fundit, më datë 06.03.2026, i ka përcjellë shkresat lidhur më çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së lidhur me këtë çështje juridike-administrative janë plotësuar kërkesat ligjore për pezullimin e procedurës administrative, *sepse*

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datë 29.12.2015, është i punësuar në pozitën Zyrtar për Teknologji Informative, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, ndërsa, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më Vendimin Nr. 2397/2025, të datës 23.12.2025, ( nr.protkoll 2397) ka transferuar përkohësisht dhe për nevoja të institucionit nga pozita Zyrtar për Teknologji Informative-Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Fushë Kosovë, Drejtoria për Pajisje me Dokumente, Agjencia për Regjistrimin Civil/MPB.

Ankuesi i pakënaqur më transferimin e përkohshëm sipas Vendimit Nr.2397/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshill më pretendimet se transferimi është bërë fillimisht pa njoftim paraprak me shkrim; Vendimi nuk është arsyetuar mbi gjendjen faktike përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim nëse punonjësi i transferuar plotëson kriteret e pozimit ku transferohet ; Transferimi duhet bazohet në atë se transferimi i përkohshëm për interes të institucionit është prej gjashtë muaj deri në 12 muaj gjatë dy viteve.

Kolegji i Këshillit në procedurë të shqyrtimit të ankesës A.nr.107/2026, ka gjetur së organi i punësimit ende pa përfunduar proceduar ankimore lidhur me kontestimin e Vendimit Nr.2397/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferimin e përkohshëm, ka ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak të shqiptimit të masës disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, sipas Vendimit me Nr. 270/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor, akt ky i kontestuar nga ankuesi përmes ankesës A.nr.288/2026, të datës 12.03.2026. Andaj, mbi këto rrethana, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së çështja ankimore e iniciuar sipas ankesës më numër A.nr.288/2026, është parakusht për zgjidhjen e ankesës me numër A.nr.107/2026, dhe si e tillë përben çështje paraprake, kështu që, në kuptim të nenit 85, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përben një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*, Kolegji vendosi që të pezullohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.107/2026, të datës 30.01.2026, deri në vendosje të ankesës me numër A.nr.288/2026 të datës 12.03.2026.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda: A.nr.107/2026*

**Merlinda RAMAJ**

Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit S.R;
- MPB: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.